



## Procesverbali i debatit publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore në fshatin Orllan

Debatin Publik e hapi drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani, e ku pjesë e këtij dëgjimi ishin edhe drejtori i drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Fatmir Rudari dhe drejtori i drejtorisë së Shëndetsisë dhe Mirëqenies Sociale, Driton Veliu.

Drejtori Osmani prezantoi buxhetin për vitin 2023, ku tha se komuna ka mbi 27 mil euro, që do të thotë ka një rritje prej 4 mil euro., e që kjo rritje vazhdon në mënyrë progresive edhe ne vitet 2024-2025.

Drejtori Osmani prezantoi qëllimin e KAB, në mënyrë që qytetarët të kenë mundësinë të japid sygjerimet e tyre në lidhje me investimet buxhetore. Ndërsa kërkesat e juaja të paraqitura nga viti i kaluar, tani më vetëm do të fillojnë të implementohen nga muaji korrik e tutje, sepse muajt e parë të vitit zakonisht kalojnë me procedura administrative të prokurimit.

Përveç investimeve të komunës, në lokalitetin e Orllanit priten të realizohen edhe dy projekte të mëdha infrastrukturore që janë në bashkëpunim me ministritë, bëhet fjalë për ndërtimin e rrugës Turuçic që lidhet me Herticë, një investim i planifikuar prej 576 mijë euro, dhe ndërtimi i rrugës Kalatic-Brainë, Bërvénik-lagjia Abdullahu ku gjithashtu edhe kjo është një rrugë me vlerë 529 mijë euro, që do të thotë bëhet fjalë për vitin 2022, dhe një pjesë e mbetur në vitin 2023, si dhe 120 mijë euro janë të ndara për rrugë të vogla në fshatin.

Komuna ka përgaditur draftin e KAB-it për vitin 2023-2025 dhe tani jemi në fazën e dëgjimeve publike me qëllim që të marrim sygjerimet e juaja lidhur me investimet ne lokalitetet e ndryshme, në këtë draft komuna ka prioritzuar sektorin e Arsimit, Shëndetësisë dhe Ekonomisë, por duke mos lënë anash as investimet infrastrukturore. Kemi rritje të dukshme në kategoritë e subvencioneve në secilën fushe, në arsim, shëndetësi, kulturë, sport si dhe bujqësi.

Korniza miratohet deri në fund të muajit qershor, dhe i paraprin buxhetit të vitit te ardhshëm. Për te mos e zgjatur unë e hapi debatin në mënyrë që jut ë ndjeheni të lirë të parashtroni kërkesat e juaja tha drejtori Osmani.

Drejtori i shkollës së Orllanit- "Kërkesat e mia do të janë kryesisht për shkollën ku e drejtoj, prioritetet tona janë; ndërtimi i një depoje, rrethojat e shkollës, ndërtimi i një fushe të sportit dhe gjithashtu edhe ndërtimi i një salle të sportit, ne kemi edhe një shqetësim sepse pullazi i shkollës pikon ujë brenda, kemi mungesë të gjitha kabineteve, ndërsa për objektin e shkollës tjetër a ka mundësi ta adaptojmë në Qendër Trajnimi të Komunitetit , si dhe kërkesa për ndërtimin e rrugës Orllan-Rakinic, pastaj mungesën e ujit të pijshëm e kemi mjaft shqetësues, si dhe kanalizimin e shkolës ”.

Banor i fshatit Bllatë- “Kam qenë disa herë në komunë në lidhje më një rrugë, por ende su ndërmerr kurgja, është rrugë e pakalushme, ju lutem ndërrmerrni dicka për të na zgjedhur këtë problem”.

Drejtori Osmani ju përgjigjet qytetarëve, “Tani në komunitetin tuaj është kthyer vëmendja dhe priten dy projekte të mëdha të cilat i përmenda më parë që kanë një kosto afër 1 mil euro , gjithashtu ndërtimi i sistemit të ujësjellsit në fshatin Orllan, ku ka një kosto rreth 400 mijë euro dhe xhamia e fshatit e cila bën pjesë në monumentet kulturore, një renovim afër 70 mijë euro, si dhe procedurat për ndërtimin e rrugëve lokale që janë në një numër të madh.

Një banor i fshatit Rakinic – “Propozoj që objektet e shkollës së vjetër, t'i propozohen Ministrisë së Mbrojtjes t'i adaptojnë në kazerma dhe t'i shfrytëzojnë për ushtrimet e tyre, pastaj rruga që lidh lagjen Osaj me Brainen, si disa rrugica të tjera të fshatit.

Një banor i fshatit Orllan don me për projektet e në vendin e tij, pyet edhe për ndalesat që janë për lagjen e tij përreth liqenit.

Një banor tjetër i fshatit të Orllanit shpreh shqetësimin për mungesën e ujit të pijshëm, ndërsa kërkesë së tij është edhe ndërrimi i shtyllave elektrike për shkak që janë dobësuar shumë dhe paraqesin rrezik për banorët.

Një banor tjetër i Orllanit shpreh shqetësimin rreth rrugës të cilën e kanë të pa asfaltuar janë rreth 8 shtëpi por rrugën e kanë në gjendje jo të mirë, është me gjatësi rreth 1 km, kanë nevojë për ndriçim dhe trotuar për shkak të vizitave të komandanti Zahir Pajaziti.

Banor tjetër shpreh falënderim ndaj drejtorëve për mbajtjen e një takimi të tillë, takime të cilat në të kaluarën kanë munguar, ai shpreh shqetësimin për tri gjëra elementare të cilat ju mungojnë: rrjeti i kanalizimit, ujësjellsi apo furnizimi më ujë të pijes, ambulanta nuk punon në dy ndërrime, punojnë vetëm deri në orën 14, ka edhe një kërkesë për kryetarin që përderisa ja kanë dhan besimin dhe votën të ka vëmendjen më shumë edhe në fshatin Orllan. Drejtori i falënderon të gjithë banorët që kanë ardh në takim dhe paraqitën kërkesat dhe shqetsimet e tyre. Drejtori Osmani potencon se në vitin 2022 tani do të fillojnë investimet në fshatin Orllan, ndërsa çështjet e trashëgimisë kulturore, Ministria e Kultures bashkë më drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit janë duke u kujdesur për të gjitha objektet të futen në mbrojetjen e trashëgimisë kulturore dhe të investohet në këto objekte. Komuniteti i juaj i cili merret me bujqësi vitin që vjen do të përfitoj shumë për shkak të rritjes së subvencioneve të bujqësisë për 2023, ndërsa sa i përket shqetsimeve të rrugëve janë të planifikuar 120 mijë euro që do të mundohemi të mbulojmë një pjesë të kërkesave për rregullimin e tyre. Ne do të bëjmë përpjekje që numër i madh i kërkesave tuaja të zgjidhen me këto mundësi që i kemi, ne ju inkurajojmë që për cdo problematic apo kërkesë që keni ta adresoni edhe tek 11 drejtorët tjerë jo vetëm nga përfaqësuesi i fshatit por edhe nga gjithë banorët pa dallim.

**06.06.2022, Podujevë**



Debat Publik për Kornizën Afat mesme Buxhetore (fshati Orllan me rrithinë



TVLLAPI



Debat Publik për Kornizën Afat mesme Buxhetore (fshati Orllan me rrëthinë)



Debat Publik për Kornizën Afat mesme Buxhetore (fshati Orllan me rrëthinë)



**Debat Publik për Kornizën Afat mesme Buxhetore (fshati Orllan me rrethinë)**